



Në bazë të nenit 3, paragrafi 2 të Rregullores nr. 03/2024 angazhimin e Ofruesve të Shërbimeve (OSH) në procesin e likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH), Autoriteti i Likuidimit shpallë këtë:

## Konkurs per Ofrues të Shërbimeve në procesin e likuidimit

Titulli i pozitës së punës	Ofrues i Shërbimeve – për punë administrative
Kohëzgjatja e emërimit	6 muaj
Paga (bruto) përfshirë kontributet e punëdhënësit	450.00 Euro
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	05.11.2024
Afati për aplikim	11.11.2024
Institucioni	Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)
Departamenti	Departamenti i Koordinimit Rajonal
Divizioni	Zyra Rajonale Prishtinë, Autoriteti i Likuidimit i PRN104 NSH Tregu
Vendi i punës	NSH "Tregu" – Tregjet e Prishtinës
Nr. i Referencës	05.11.2024 – OSH Administratë

### 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

- Ofruesi i shërbimeve caktohet në pozitën **Administratë**;
- Ndihma në kryerjen e detyrave administrative,
- Ruajtja dhe organizimi i dosjeve dhe dokumenteve të ndryshme të Ndërmarrjes, duke përfshirë kontratat e qirasë, raportet financiare, dhe dokumentet ligjore,
- Përgatitja e dokumenteve të nevojshme dhe sigurimi i arkivimit të saktë të tyre për referenca të mëvonshme,
- Krijimi i faturave mujore për qiradhënësit dhe sigurimi që të gjitha informacionet janë të sakta dhe të plota,
- Ndjekja e pagimeve për të siguruar mbledhjen në kohë,
- Përgjigja ndaj kërkesave dhe informacionit të kërkuar nga qiradhënësit, klientët, dhe autoritetet e tjera,
- Ruajtja e regjistrave të ndryshëm si regjistrat e pagesave, regjistrat e qiradhënësve, dhe regjistrat e inventarëve,
- Ofruesi i shërbimeve i caktuar në këtë pozitë i kryen punët dhe detyrat shtesë sipas kërkesës së mbikëqyresit të drejtpërdrejt.

### 2. Kërkesat e përgjithshme për pranim

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.



### 3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimimi i kërkuar: Diplomë universitare në Biznes, Ekonomi, Financa, Kontabilitet, Juridik apo ngjashme
- Njohuri të mirë pune me pakon e programeve të Microsoft Office;
- Të jetë i përpiktë dhe të ketë aftësi organizative;

### 4. Kërkesa specifike

- Përvoja në punë/aktivitet të ngjashëm si dhe ish punëtorët e kësaj NSh-je me përvojë të ngjashme do të konsiderohet përparësi;

### 5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Aplikacioni i punësimit (konsiderohet si CV dhe vlerësohet nga Komisioni);
- Kopjet e diplomave mbi kualifikimin arsimor;
- Dëshmi për përvojën e punës;
- Kopjen e letërnjoftimit/Pasaportës;
- Certifikatë nga Gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit si dhe
- çdo dokument që provon plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruara në aplikacion.

### 6. Mënyra e Aplikimit

- Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kompletuar më së largu me datë 11.11.2024 në ora 16:00 në emalin [punesimi@pak-ks.org](mailto:punesimi@pak-ks.org) apo në Agjencinë Kosovare të Privatizimit - Zyra Rajonale të Prishtinës me adresë në Rr. "Dritan Hoxha", 55, Lakrishtë, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

### 7. Data e shpalljes së rezultateve të vlerësimit përfundimtar

- Lista e kandidateve sipas vlerësimit përfundimtar, do të shpallet më së largu deri më datën 15.11.2024, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://www.pak-ks.org/page.aspx?id=1,33>).

### 8. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes kontakt telefonit, SMS dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://www.pak-ks.org/page.aspx?id=1,33>)
-